



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __. __. 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "Fuqizimi i stacionit të pompimit të ujitjes nga lumi
Seman, zona Suk-Arapaj, Bashkia Roskovec" (furnizim-vendosje)".**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Pompa nën
ujore : 43134100-2; Pajisje ujitje: 43323000-3 ;****

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2 018 932 (dy milion e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqindë e
tridhjetë e dy) lekë pa tvsh**

Argumentimi i fondit limit: Shoqëria "SELAS Ltd" për argumentimin e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)", Shoqëria "SELAS Ltd" për llogaritjen e cmime të zërave në preventiv i është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015, (ndryshuar me VKM-në nr.631, datë 26.10.2018, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit (E HAPUR E THJESHTUAR) është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" nenin 49 i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik", si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nenin 11, pika 1, gërma b dhe neni 55.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per

prokurimin publik” dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;;”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

c. Formulari i Ofertës ,sipas Shtojcës 1

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas zërave të preventivi sipas shtojcës 2;

Shenim: Dokumentat e kërkuara më sipër në pikën d dhe c do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 dhe 2 te DST).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik"; nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës e përkatësisht: 800 000 lekë pa tvsh.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik"; si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: **"Fuqizimi i stacionit të pompimit të ujitjes nga lumi Seman, zona Suk-Arapaj, Bashkia Roskovec" (furnizim-vendosje)**", pika 3 e nenit 77 të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të

tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit neni 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023..

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik"; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar, si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **400 000 lekë**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Me qëllim krahasimin e specifikimeve teknike të ofertuara me ato të kërkuara në preventiv, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun/ fragmentin e katalogut teknik të pompes, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në preventiv.

Argumentimi: Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;... 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit vlerëson se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dokumentacionin (katalogun/

fragmentin e katalogut teknik të pompës) e kërkuar, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të mallit të ofruara, me mallin e kërkuar objekt kontrate.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

a) **Certifikate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë / ekuivalente dhe e vlefshme**

- *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të preventivit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Argumentimi: Kërkesa e cilësisë të përcaktuara sipas pikës **2.3.3** gërma “a” është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79 i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë të mallve me çmime të ulta.

2.3.4 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

<u>Mjetet</u>	<u>Sasia</u>	<u>Gjendja</u>
----------------------	---------------------	-----------------------

Kamionçin me kapac mbajtes mbi 3 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Skrep	1 cope	Pronësi ose me qera

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar I pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit e vlefshme dhe fotot perkatese;
- (b) Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.
- (d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.Pra mjetet e kërkuara do të jenë të nevojshëm për kryerjen e **punimeve të ndërtimit për montimin ,përgatitjen dhe instalimin e pompës nga OE..**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Autoritetet Kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NP.1 - A (Punime germimi në toke)**
- **NP.7-A(Ujësjetllës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)**

NP. 1-A Punime gjermimi në tokë

- **Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.**
- N.P. 7 –A Konsiderohen ndërtime , mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “ e shërbimit hidrik kompleks” dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të vecanta , si dhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit , informimit ,sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.
- Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit,, ujësjellsit , kullat e ujit,stationet e pompimit depozitat në tokë ose të ngritura , rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në veprë e tubacioneve, shkarkimet e ujrave të zeza, si dhe trajtimin e ujrave të përdorura.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

-
-

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që përkasin kategorinë përkatëse
NP.1-A Punime gjermimi në tokë	Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	1.Germim dheu për veprën 2.Thyerje dhe hedhje copa betoni Beton M 250 për riparime dhe përforcim e bazamentit ekzistues të ngrehinës së st. Pompës	Niveli A	58582 lekë pa tvsh
N.P. 7 –A Ujësjellës, kanalizime ,vepra kullimi e vaditje	Konsiderohen ndërtime , mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “ e shërbimit hidrik kompleks” dhe	1. Prerje, e cmontim me detaje metalike tubacione Fi 200-400mm ne linjën ekzistuese të thithjes e dergimit 2. Punime për përgatitje e vendosjen e montim të pompës agregat e të paisjeve të tjera elektomekanike në	Niveli A	128322 leke pa tvsh

	<p>veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të vecanta , si dhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit , informimit ,sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit,, ujësjellsit , kullat e ujit, stacionet e pompimit depozitat në tokë ose të ngritura , rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në veprë e tubacioneve, shkarkimet e ujrave të zeza, si dhe trajtimin e ujrave të përdorura.</p>	<p>stacionin e pompimit, 3.F.V Konstruksione metalike Fi 200 deri Fi 400 mm, beryla.rakordime,ne segmentin e thithjes e te dergimit etj.</p>		
--	--	--	--	--

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin

e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

2.3.6-Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar të paktën **5 (pesë) punonjësish**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Numri i punonjësve është llogaritur në bazë të zberthimit të preventivit, të afatit të zbatimit të kontratës dhe natyrës së objektit, numri prej 5 personash përfshin punonjës të specializuar/të kualifikuar si dhe numrin e punëtorëve të thjeshtë përlllogaritur nga zberthimi i preventivit, dhe natyrës së objektit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklaroj disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Shtojca 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar.
- Listë pagesat e punonjësve të konfirmuar nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën fundit të deklaruar.

Argumentim: *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 5 është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet

dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.7 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar 1(një) elektrikist dhe 1(një) saldator, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë /dëshmi kualifikimi përkatëse .

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

2.3.8-Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar (1) shofer dhe 1(një) manovrator për skrepin ,për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Për pikat më sipër konkretisht 2.3.6 - 2.3.8, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pare duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit** , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020

"Per prokurimin publik" Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Shofer/Manovrator që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

2.3.9 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet : "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*", si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, **nr.58, datë.29.05.2024**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: "**Fuqizimi i stacionit të pompimit të ujitjes nga lumi Seman, zona Suk-Arapaj, Bashkia Roskovec**" (furnizim-vendosje)", me fond limit prej: **2 018 932 (dy milion e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqindë e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh , lloji i procedurës: E hapur e thjeshtuar.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë

zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdher të Titullarit për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden vetëm në preventive,bashkelidhur dst ne SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

*Argumentim Sp.teknike:Anëtarët pranuan dokumentacionin teknike të hartuara dhe mar në dorëzim të dokumentacionit teknik të **Shoqërisë ” SELAS Ltd** nga Komisioni i posaçëm :**KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt **nr.3562prot,datë15.05.2024**,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për pajisjen(F.V) që do të blejë.**Preventivi është***

hartuar hartuara nga Shoqëria ” SELAS Ltd,dorëzuar dokumentacioni teknik si preventivi + projekti me procesverbalin e komisionit nr. nr.3562/1prot,datë27.05.2024dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit.

Preventivi i hartuara nga Shoqëria ” SELAS Ltd si mëposhtë për objektin: ”Fuqizimi I stacionit të pompimit të ujitjes nga lumi Seman,zona Suk Arapaj,BashkiaRoskovec”(furnizim-vendosje)”.

Sasia e mallit që kërkohet

PREVENTIVI PËRMBLEDHËS NE FORMAT WORD

Nr	Nr An	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA
		A. Punime ndërtimi montimi për përgatitjen dhe instalimin e pompave		
1	3-59-b	Gërmime dheu për veprën	m ³	22.56
2	2-426	Thyerje dhe hedhje copa betoni	m ³	1.4
3	3-244	Beton M 250 për riparime dhe përforcim e bazamentit ekzistues të ngrehinës së st. Pompës	m ³	2.4
4	Analizë	Prerje, e cmontim me detaje metalike tubacione Fi 200-400mm ne linjën ekzistuse të thithjes e dergimit	Ton	0.57166
5	4-3	F.V Konstrukione metalike Fi 200 deri Fi 400 mm, beryla.rakordime,ne segmentin e thithjes e te dergimit etj.	Ton	0.380
6	An 3	Punime për përgatitje e vendosjen e montim të pompës agregat e të paisjeve të tjera elektomekanike në stacionin e pompimit,	o.p	96
		Shuma A		
		Fonde rezerv 5%	Lekë	
		Shuma	Lekë	
		TVSH 20%	Lekë	
		Shuma e punimeve të ndërtim montimit	Lekë	
		B.Blerje e transport në objekt I paisjeve e makinerive		
1	An 9	Blerje paisje dhe makineri,pomp centrifugale me gjith electromotor dhe lëshuesit automatic me”soft starter”,Prurja e pompes,Q=152 l/sek,Lartësia(Bruto me gjith humbje) H=12, 5 m Fuqia e përafërt P=30KË	copë	1
		Fond rezerv 10%	lekë	
		Shuma B(për makineri paisje)	lekë	
		KOSTO TOTALE A+B	lekë	

Shënim:

Punimet për furnizimin dhe blerjen e makinerive e paisjeve dhe disa punime të parashikuara në analizat e cmimeve të mësipërme janë dhënë të përafërta, në analogji me punime për objekte të ngjashme.

Saktësimi I tyre do të bëhet gjatë zbatimit të punimeve në përshtatje me kushtet e krijuara dhe tipin e pompave që sigurohen.

Në vlersimin e punimeve elektrike është parashikuar që të shfrytëzohet linja dhe transformatorët ekzistues

Afatet e lëvrimit: Fillon nga **data e nënshkrimit të kontratës dhe** mbaron deri më 60 **(gjashtëdhjetë)ditë.**

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: